

GUSHT 2026

BULETINI



Reagimet e ACDC-së ndaj çështjeve aktuale të sundimit të ligjit

Gjatë muajit gusht, ACDC, së bashku me organizata të tjera të shoqërisë civile, reagoi ndaj disa çështjeve aktuale me rëndësi për sundimin e ligjit, përgjegjshmërinë institucionale dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.



Shqetësime lidhur me rrënimin e objekteve në Liqenin e Ujmanit

ACDC dhe organizata të tjera të shoqërisë civile shprehën shqetësimin e tyre lidhur me mënyrën se si po zbatohet rrënimi i objekteve në zonën e Liqenit të Ujmanit, duke ngritur çështje që kanë të bëjnë me ligjshmërinë, të drejtën për mjete juridike, proporcionalitetin dhe barazinë para ligjit. Organizatat kërkuar pezullimin e rrënimeve të mëtejshme derisa të sqarohet baza ligjore e këtyre veprimeve dhe pronarëve t'u sigurohet mbrojtje e plotë juridike.



Kërkesë për vlerësimin e monitorimit të Policisë së Kosovës nga EULEX-i

Pas pretendimeve për keqtrajtimin policor të Nenad Rašković-it, ACDC dhe organizata të tjera të shoqërisë civile kërkuar një hetim urgjent dhe të pavarur, si dhe vlerësimin e efektivitetit të monitorimit të punës së Policisë së Kosovës nga EULEX-i. Organizatat iu drejtuan nivelit përkatës të Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm në Bruksel, duke kërkuar informacione më të qarta mbi rezultatet dhe efektet e monitorimit ndërkombëtar.



Standarde të ndryshme ligjore në Liqenin e Ujmanit dhe Liqenin e Radoniqit

ACDC dhe organizata të tjera të shoqërisë civile vunë në dukje trajtimin e ndryshëm nga institucionet gjatë largimit të objekteve në Liqenin e Ujmanit dhe Liqenin e Radoniqit. Ndërsa në Liqenin e Radoniqit është zhvilluar një procedurë gjyqësore disavjeçare, pronarëve në Liqenin e Ujmanit u janë dhënë vetëm 15 ditë për t'i liruar pronat, pa një vendim paraprak gjyqësor. Organizatat paralajmëruan se kjo ngre çështje lidhur me zbatimin selektiv të ligjit, barazinë para ligjit dhe të drejtën për mbrojtje juridike.



TAKIM ME PËRFAQËSUESIN E ZVICRËS
Drejtori i Programeve i ACDC-së, Aleksandar Rapajić, mori pjesë në një takim të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile me të Ngarkuarin me Punë të Zvicrës, Christoph Fuchs, gjatë vizitës së tij në veri të Kosovës.


Gjatë takimit u diskutua për situatën aktuale, sundimin e ligjit, shqetësimet e popullsisë lokale, si dhe rëndësinë e dialogut, transparencës dhe angazhimit të vazhdueshëm për ruajtjen e stabilitetit dhe besimit.

FILLOI PROJEKTI “BRINGING PRIDE TO THE NORTH 2.0”

Në gusht, ACDC filloi zbatimin e projektit “Bringing Pride to the North 2.0”, i cili paraqet vazhdimin e projektit të parë kushtuar përmirësimit të pozitës dhe dukshmërisë së komunitetit LGBTQI+ në veri të Kosovës.

GGjatë gjashtë muajve të ardhshëm, përmes edukimit dhe një fushate publike, projekti do të kontribuojë në informimin më të mirë të publikut, zvogëlimin e paragjytimeve dhe krijimin e një komuniteti lokal më të hapur dhe gjithëpërfshirës. Projekti mbështetet nga Bashkimi Evropian, në bashkëpunim me CCE, ERA, CSGD, OMSA, Queer Montenegro, Queer Center dhe Tuzla Open Centre.

Me fillimin e projektit u lansua edhe një fushatë edukative në rrjetet sociale, përmes së cilës ACDC gjatë muajve të ardhshëm do të prezantojë tema që lidhen me të drejtat LGBTQI+, barazinë, përfshirjen dhe luftën kundër diskriminimit. Publikimi i parë, “Çfarë fshihet pas shkronjave LGBTQI+?”, i prezantoi publikut konceptet bazë dhe identitetet e ndryshme që përfshin kjo shkurtesë.



ACDC në media

Gjatë muajit gusht, përfaqësuesit e ACDC-së folën për media lidhur me çështjet aktuale të sundimit të ligjit, gjyqësorit dhe sigurisë në veri të Kosovës.

Drejtori Ekzekutiv i ACDC-së, Dušan Radaković, foli për Kontakt Plus lidhur me problemet në funksionimin e gjyqësorit, pozitën e komunitetit serb dhe sfidat në qasjen në drejtësi, duke vënë në dukje edhe shembuj të standardeve të ndryshme në zbatimin e ligjit.



Drejtori i Programeve i ACDC-së, Aleksandar Rapajić, foli për Kosovo Online lidhur me tërheqjen e KFOR-it nga Ura Kryesore mbi lumin Ibër, duke vlerësuar se ky veprim ka një karakter të rëndësishëm simbolik në një kohë kur besimi i komunitetit serb ndaj Policisë së Kosovës është i ulët.



SË SHPEJTI: FAQJA E RE E INTERNETIT DHE STRATEGJIA E RE E ACDC-së
ACDC është në fazën përfundimtare të përgatitjes së faqes së re dhe të ridizajnuar të internetit, e cila do të mundësojë qasje më të qartë dhe më të lehtë në informacionet për punën, projektet, hulumtimet dhe publikimet tona.
Në të njëjtën kohë, ka përfunduar hartimi i Strategjisë së re të ACDC-së për periudhën 2026–2031, e cila do të shërbejë si bazë për zhvillimin e mëtejshëm programor dhe organizativ të ACDC-së.